



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER VALBONA SH. SELIMI  
ADRESA NR.3, HOXHA TASIM,  
NR.292  
TEL: 695761243

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME (AKSIONE)

Nr. repertori: 2548

Nr. koleksioni: 716

Tirane më 13/04/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2021052730076231019



A2021052730076231019

## KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sdi, më datë 13.04.2021, para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.3, HOXHA TASIM, NR.292, u paraqiten personalisht apo nepermjet perfaqesuesve me prokure:

### SHITES:

**Klajdi Çeçi**, atësia Zaim, amësia Qibarije, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në POGRADEC, me adresë Koco Sotiri 02620073; Nd. 20; H. 1; Pogradec; Pogradec; 7301; Pogradec, lindur më 13/04/1987, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 036388103 dhe nr. personal I70413095L, i përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e posaçme" me Nr. Rep 3054, Nr. kol 1663, datë 21/10/2020, nga përfaqësuese **Anxhela Lami**, atësia Agostin, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, lindur më 17/09/1992, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova nga karta e identitetit me nr. personal J25917074H.

**Emiljan Çeçi**, atësia Gezim, amësia Valbona, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Mine Peza; Nd. Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 27/12/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 036171453 dhe nr. personal J112270450, i përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e pergjithshme" me Nr. Rep 1010, Nr. kol 304, hartuar nga notere Valbona Selimi, në datë 11/03/2019, nga përfaqësuese **Anxhela Lami**, atësia Agostin, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, lindur më 17/09/1992, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova nga karta e identitetit me nr. personal J25917074H. ( me tej referuari si "Shitesi")

### BLERES:

**Emiljan Çeçi**, atësia Gezim, amësia Valbona, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë Mine Peza; Nd. Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 0000; Tiranë, lindur më 27/12/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 036171453 dhe nr. personal J112270450, i përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e pergjithshme" me Nr. Rep 1010, Nr. kol 304, hartuar nga notere Valbona Selimi, në datë 11/03/2019, nga përfaqësuese **Anxhela Lami**, atësia Agostin, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, lindur më 17/09/1992, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova nga karta e identitetit me nr. personal J25917074H.

**Anxhela Lami**, atësia Agostin, shtetase shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, lindur më 17/09/1992, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova nga karta e identitetit me nr. personal J25917074H.



A2021052730076231019

(me tej referuar si "Bleresi")

(se bashku te referuar "Palet")

**DUKE QENE SE:**

Shitesit Emiljan Çeçi dhe Klajdi Çeçi jane ortakë perkatesisht Emiljan Çeçi zoteron 50.10 % dhe Klajdi Çeçi zoteron 49.90 % të kapitalit te regjistruar te Shoqërisë "Ceci Corp Attorneys" sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi (NUIS) **L82128031L**, e organizuar në bazë të ligjeve shqiptare, me adresë ne TIRANE Rruga e Barrikadave, Pallati nr.18, kati 3, hyrja 8, me një kapital prej 250.000,00 Leke, më tej referuar si "**Shoqëria**";

- A. Blerësi dëshiron të blejë nga Shitesit dhe Shitesit dëshiron t'i shesin Blerësit, një pjesë te kuotave që Shitesit zoterojnë, konkretisht Emiljan Çeçi do te shese 7.5 % te kuotave dhe Klajdi Çeçi do te shese 7.5 % te kuotave dhe qe përfaqëson ne total 15% të kapitalit të Shoqërisë (më tej referuar si "**Kuota**");
- B. Blerësi dëshiron të blejë nga Shitesit dhe Shitesit dëshiron t'i shesin Blerësit, një pjesë te kuotave që Shitesit zoterojnë, konkretisht Klajdi Çeçi do te shese 42.4 % te kuotave të kapitalit të Shoqërisë (më tej referuar si "**Kuota**");
- C. Palet deklarojne se Shitesit kane financuar Shoqerine per kuotat 57.4% ne shumen 143500(njeqind e dyzete e tremije e peseqind ) leke (ne vijim "**Financimi**"). Palet bien dakort ne kete marreveshje per kthimin e Financimit tek Shitesit. Gjithashtu palet bien dakort qe ne rast se nga ky transferim i kuotave do te rezultojte tatim, kjo pagese do te ngelet detyrim i shoqerise.
- D. Palët kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje, me qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të angazhimit të tyre respektiv për shitjen dhe blerjen e kuotave.
- E. Palët kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje, me qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të angazhimit të tyre respektiv për shitjen dhe blerjen e kuotave.

**PALET BIET DAKORD SA VIJON:**

**1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME**

**1.1 Përkufizime**

Termet me shkronja te medha shtypi ne kete Marreveshjeje do te kene kuptimin e percaktuar ne vijim:

"**Barrë**" nënkupton cdo pretendim, interes apo e drejte e cdo individi (duke përfshirë cdo të drejtë për të blere, mundesi per te blere ne te ardhmen apo te drejte parablerjeje) ose cdo hipoteke, kolateral, peng, cedim, kufizim, interes sigures (duke përfshirë edhe ato të krijuar me ligj), ruajte te drejte ose cdo marrveshje sigurimi apo marreveshje ose rregullim tjetër barresues apo marreveshje qeraje, qeraje financiare, shitje me kredi apo marreveshje tjeter per pagim me rezerve;



A2021052730076231019

"Qendra Kombëtare e Biznesit" nënkupton organin publik Shqiptar që ka kompetencën e regjistrimit në regjistrin tregtar të Shqipërisë.

## **2. TRANSFERIMI I KUOTAVE**

### **Shitja e Kuotave**

- 2.1.1 Ne perputhje me kushtet e parashikuara ne kete Marrëveshje Shitësit shesin duke kaluar në pronësi të plotë të Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësit Kuota, të lira dhe të parënduara me ndonjë Barre.
- 2.1.2 Transferimi i Kuotes do të bëhet në përputhje me kete Marreveshje dhe të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi.
- 2.1.3 Titulli i pronesise mbi Kuoten do të transferohet tek Blerësi ne momentin e shlyerjes se Cmimit te Blerjes si me poshte. Kuota do të shitet së bashku me të gjitha të drejtat dhe perfitimet që lidhen me to ose që u jepen atyre deri ne daten e kalimit te ponesise mbi kuoten (duke përfshirë të drejtën për të marrë gjithë dividentin,shpërndarjen ose ndonjë kthim të kapitalit të deklaruar, të paguar ose të realizuar nga Shoqëria deri me sot).

### **2.2 Cmimi i Blerjes**

Blerësi i paguan Shitësit per blerjen e Kuotave shumen totale prej 143500(njeqind e dyzete e tremije e peseqind ) leke.

#### **Pagesa e Çmimit të Blerjes**

Palet deklarojne se pagesa e cmimit te blerjes do te behet me transferte bankare, dhe deshmia e pageses kushtezon regjistrimin e kesaj kontrate ne QKB.

### **2.3 Vendimi i Ortakut**

Shitesit deklarojne se e miratojne kete shitje kuotash dhe se kete miratim e reflektojne ne vendimin e ortakut te Shoqerise qe vendos mbi miratimin e transferimit të Kuotes nga Shitësit tek Blerësi.

### **2.4 Kthimi i Financimit dhe ndryshimet e metejshme te kuotave**

Me lidhjen e kesaj marreveshje Bleresi merr persiper qe te shkaktoje qe Shoqeria te ktheje me transferte bankare tek Shitesi Financimin per 57.4 % te kuotave (ne shumen totale prej 143500 (njqind e dyzete e tremije e peseqind ) leke brenda nje afati 7 ditor nga momenti i lidhjes se kesaj marrveshje.

## **3. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **3.1 Marrëveshja dhe Amendamentet**

- 3.1.1 Kjo Marrëveshje zhvleftëson cdo marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje.



A2021052730076231019

- 3.1.2 Cdo ndryshim i kësaj Marrëveshje është i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar prej ose në emër të secilës prej Palëve dhe i referohet në mënyrë specifike kësaj Marrëveshje.

### 3.2 Transferimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme për zbatim dhe do të zbatohet edhe prej pasardhësve të Palëve por nuk do të jetë e transferueshme pa miratimin paraprak me shkrim të Palëve të tjera.

### Regjistrimi i Marrëveshjes

Palet bien dakort se regjistrimi i Marrëveshjes ne Qendren Kombëtare te Biznesit do te behet nga Bleresi brenda nje afati 15 ditor.

## 4. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Kjo marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare. Palët bien dakort që cdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Marrëveshjes të zgjidhet nëpërmjet Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

\* \* \*

Akti u redaktua konform vullnetit te plote te paleve te cileve pasi ua lexova marreveshjen dhe pasi deklaruan se u kuptua prej tyre, e nenshkruan rregullisht para meje noteres dhe une Noterja vertetoj nenshkrimin e tyre konform Ligjit.

### Shitesi

**Klajdi Çeçi**

I perfaqesuar me prokure nga

Anxhela Lami

**Emiljan Çeçi**

I perfaqesuar me prokure nga

Anxhela Lami

### BLERES

**Anxhela Lami**

Anxhela Lami

**Emiljan Çeçi**

I perfaqesuar me prokure nga

Anxhela Lami

**NOTERE VALBONA SELIMI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE KORÇË

NOTER THOMA S. BICE  
ADRESA NR.1, RESHIT COLLAKU,  
NR.9  
TEL: 692020018

## PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 3054

Nr. koleksioni: 1663

Pogradec më 21/10/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 1 fletë



A2020031620174598366

PROKURË E POSAÇME

Sot, ne Pogradec, para meje Noter THOMA S. BICE, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore KORÇË, me zyrë në adresën Pogradec, NR.1, RESHIT COLLAKU, NR.9, u paraqit personalisht:

**I PERFAQESUAR:**

Klajdi Çeçi, atësia Zaim, amësia Qibarije, shtetas Shqiptar, lindur në Korçë dhe banues në POGRADEC, me adresë Koco Sotiri 02620073; Nd. 20; H. 1; Pogradec; Pogradec; 7301; Pogradec, lindur më 13/04/1987, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036388103 dhe nr. personal I70413095L, ortak i Shoqëise "CECI CORP ATTORNEYS" shpk I cili me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noteri redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 "Për Noterinë", si më poshtë vijon:

"Unë i përfaqësuari i mësipërm, Emëroj si përfaqësues të posaçëm Anxhela Lami, atësia Agostin, amësia Luljeta, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në adresën Artan Lenja; Nd. 57; H. 13; Ap. 16; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, ie datëlindjes 17/09/1992, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033785334 dhe nr. personal J25917074H, te ciles i jap te drejte te nenshkruaje vendimin e Asamblese te Ortakeve te Shoqerise "CECI CORP ATTORNEYES" shpk per transefrimin e kapitalit, te me perfaqesoje prane Qendres Kombetare te Biznesit per kryerjen e veprimeve te ndryshme si dhe te nenshkruaje kontraten per shitjen e kuotave.

E prorositura ka te drejte te me perfaqesoj prane cdo organi te administrates shtetore,organeve te pushtetit lokal ,personave juridike e fizike privat per te terhequr, dorezuar cdo dokument te nevojshem ne emer tim.

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe për një kohë të pacaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e revokimit të saj në çdo kohë. E/I përfaqësuar/i deklaroi se: *"Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi im i posaçëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më nje legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar, do ti konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje".*

Prokura e Posaçme, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarës, e cila e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e saj të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noterit.

Kjo Prokurë e Posaçme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 3 (tre) kopje, me vlere të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarës. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, kopjet e tjerë për të përfaqësuarin.

Unë Noteri, verifikova identitetin e të përfaqësuarës nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të neni 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroi se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**(/E) PERFAQESUAR**

Klajdi Çeçi

KLAJDI ÇEÇI

NOTER  
THOMA S. BICE

g



## PROKURE E PERGJITHSHME

Sot, me date 11/03/2019 perpara meje Noteres se Dhomes se Notereve Tirane, Valbona Selimi, me seli ligjore ne Bulevardi Zogu i Pare, Tirane, u paraqit personalisht:

### I PERFAQESUARI:

1. **Emiljan Çeçi**, i biri i Gezimit, i datelindjes 27/12/1991, lindur ne Korçe dhe banues ne Tirane, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten me nr.BA8486702 e nr.personal J112270450;

*i cili me kerkoi redaktimin e kesaj prokure te pergjithshme si me poshte vijon :*

"Caktoj si perfaqesuesen time te pergjithshme avokaten Anxhela Lami, avokate prane Dhomes se Avokatise Tirane per te me perfaqesuar ne mungesen time lidhur me cdo ceshtje gjyqesore te filluar nga une apo kunder meje nga cdo pale e trete, ne mbrojtje te interesave te mia kundrejt cdo pale, me cfaredo objekt te padise, apo kerkeses, perpara gjykatave te te gjitha shkalleve, ne te gjitha ceshtjet gjyqesore ne te cilat une jam pale dhe mund te nderhyj si pale e interesuar dhe pale e trete.

Per sa me siper perfaqesuesja ime ka te drejte te me perfaqesoje perpara te gjitha autoriteteve, enteve publike dhe shteterore, Gjykatat e Rretheve Gjyqesore, Gjykatën Administrative Tirane, Gjykatën Administrative te Apelit Tirane, Gjykatat e Apelit, dhe Gjykatën e Larte ne Shqiperi, deri ne zgjidhjen perfundimtare te ketyre ceshtjeve, duke me perfaqesuar edhe prane Zyrave Permbarimore per ekzekutimin e vendimeve.

Perfaqesuesja ime ka te drejte te nenshkruaje ne emrin dhe per llogarine time kerkese padi, kunder padi, ankime, rekruse, kunder rekurs si dhe te gjitha llojet e kerkesave qe do te paraqiten para autoriteteve shteterore dhe administrative, te kerkoje informacione nga cdo institucion shteteror, te terheqe dhe depozitoje cdo lloj prove per zgjidhjen e ceshtjes gjyqesore, si dhe te ndermarre cdo lloj veprimi ne perputhje me qellimin e Nenit 97 te Kodit te Procedures Civile, perfshi terheqjen nga padia, ankimi, rekursi, etj.

Perfaqesuesja ime ka te drejte te beje permbledhje, pyetje, parashtime, verifikime, te kerkoje marrjen e provave, t'i pergjigjet veprimeve zyrtare etj. si dhe te ndermarre cdo lloj veprimi tjeter qe ajo e vlereson te nevojshem per zgjidhjen e ceshtjeve gjyqesore.

Perfaqesuesja ime ka te drejte te kerkoje caktimin e ekspertit, te kerkoje ndryshimin e gjyqtarit, te beje ndryshime ne objektin e padise si dhe cdo ndryshim tjeter qe e shikon te arsyeshme ne mbrojtje te interesave te mia, dhe cdo veprim tjeter i cili ndonse nuk eshte shprehur ne kete prokure eshte i nevojshem per te mbrojtur interesat e mia.

Me tej, perfaqesuesja ime eshte e autorizuar te ndermarre cdo lloj veprimi tjeter ligjor apo faktik ne emrin dhe per llogarine time ne lidhje me ceshtjet e trajtuara ne kete prokure.

Per mbrojtjen e interesave te mia perfaqesuesja e zgjedhur prej meje ka te drejte qe ne emrin tim te veproje perpara organeve te administrates shteterore dhe prane zyrave noteriale per marrjen e dokumenteve zyrtare apo private (perfshire vertetimeve, certifikata, apo akte te tjera) te nevojshme per t'i paraqitur ne gjykate.

Perfaqesuesja ime ka te drejte te paraqitet ne organet e ndryshme te administrates shteterore e publike, Bashki, Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurise se Paluajtshme, zyre noterie, arshive,



etj, per te terhequr, kerkuar apo per te dorezuar dokumenta te ndryshme, marre certifikata e vertetimit, bere deklarata noteriale, etj. marrjen e karteles se perfaqesuar apo cdo lloj dokumenti tjeter njesoj sikur te isha une vete prezent.

Perfaqesuesja ime ka te drejte qe ne emrin tim te perpiloje dhe nenshkruaje kerkesa per Zyren Vendore te Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme kudo qe une kam pasuri te paluajtshme pa asnje kufizim per rregjistrimin ne rregjistrat e transkriptimeve dhe pajisjen me certifikate pronesia per cdo pasuri te paluajtshme qe rezulton ne emrin tim. Gjithashtu perfaqesuesja ime ka te drejte te veproje ne emrin dhe per llogarine time per cdo ceshtje qe lidhet me te drejtat pasurore dhe jopasurore qe figurojne ne emrin tim. Ajo ka te drejte te veproje ne emrin dhe per llogarine time per te nenshkruar cdo kontrate tjeter ku une do jem pale, si kontrate pjesetimi pasurie paluajtshme etj. si dhe te beje rregjistrimin e pasurise qe une do perfitoj ne baze te ketyre kontratave ne Zyrat Vendore te Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, Perfaqesuesja ime ka te drejte te beje ankime tek Kryerregjistruesi ne rast se refuzohet rregjistrimi i prones dhe leshimi i certifikatave se pronesise ne emrin tim.

Perfaqesuesja ime ka te drejte te perpiloje, nenshkruaje e paraqese kerkesa padi ne gjykate, kunder Zyrave Vendore te Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme dhe Zyres Qendrore te Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, me objekt kundershhtimin e refuzimit dhe detyrimin te rregjistroje pronat e mia dhe te leshoje certifikaten e pronesise, ne baze te nenit 324 te K.Pr.Civile etj.

Ajo ka te drejte te veproje edhe per te gjitha rastet e tjera te paparashikuara ne kete prokure, per te na perfaqesuar per veprime qe do t'i kerkohen ose te terheqe dokumenta dhe/ose cdo akt te nevojshem dhe/ose te nenshkruaje cdo dokument tjeter qe do te jete i nevojshem ne marredheniet me organet gjyqesore, noteret, bankat e niveleve te ndryshme, organet e gjendjes civile per terheqje te certifikave personale apo familjare si dhe plotesimin e cdo dokumenti tjeter, zyrat e rregjistrimit te pasurive te paluajtshme, organet e tjera te pushtetit dhe administrates, qendrore ose vendore, te bashkive, te komunave, te keshillave te tyre, personat fizike dhe juridike, private dhe shtetore, te hetimit, zyrat e permbarimit, te prefekturave, etj., edhe pse jo te permendura ne kete prokure, pa qene nevoja e ndonje akti tjeter, me te cilen une do te duhej te rishfaqja vullnetin tim per ratifikimin e tyre.

Per mbrojtjen e interesave te mia perfaqesuesja ime ka te drejte te kryeje edhe cdo veprim tjeter i cili mund te mos jete shprehur qarte ne kete prokure por eshte i nevojshem per realizimin e veprimeve te permendura me siper.


Kjo Prokure eshte e vlefshme nga momenti i nenshkrimit te saj dhe per nje kohe te pacaktuar me te drejten e revokimit ne cdo kohe.

Te gjitha veprimet e kryera nga perfaqesuesja ime konsiderohen te vlefshme dhe te rregullta si te ishin kryer nga vete ne.

Kjo Prokure eshte hartuar prej meje noteres dhe pasi ju lexua te perfaqesuarit, i cili pasi e gjeti ate ne perputhje me vullnetin e tij te lire e nenshkruan ate rregullisht dhe une Noterja e vertetoi nenshkrimin e saj ne perputhje me ligjin.

**I PERFAQESUARI**

Emiljan Çeçi



EMILJAN ÇEÇI

**NOTERE  
VALBONA SELIMI**

